



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 24, datë 09 .04. 2013

**PËR**

**“MIRATIM DHËNIE AMBJENTI NË PËRDORIM SHOQATËS KOMBËTARE PËRPERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR “SHPRESA PËR JETËN”, ME DESTINACION PËR QENDËR SOCIALE”.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/I, shkronja ”b”, nenit 32, shkronja “e” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 14 të ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 për “Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar), nenit 901 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit Bashkacak nr.69, datë 20.12.2005 për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.834, datë 13.12.2006 për “Miratimin e Listës së Pjeshme të Inventarit (pjesa e pare + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë, të Qarkut Tiranë” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 28.07.2007 për “Miratimin e listës paraprake e pronave të paluajtshme shtetërore për të cilat Bashkia e Tiranës kërkon transferimin në pronësi të saj”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtim për Shoqatën Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar “Shpresa për Jetën”, të një ambjenti me sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup>, sipas gentplanit bashkëngjitur këtij vendimi, për një periudhë 2-vjeçare.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale dhe Ndërmarrja Ofiçina e Automjeteve, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**